



Tiranë, më 17 Janar 2023

## **Reagim i përbashkët i një grupimi organizatash të shoqërisë civile për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme**

### **Hyrje**

Ne, një grup i organizatave të shoqërisë civile, në fokus të misionit të të cilave është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe garantimi i zhvillimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe standartet ndërkombëtare, po monitorojmë proaktivisht procesin zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Shqipëria ka nisur tashmë bisedimet për anëtarësim në BE dhe zgjedhjet lokale janë procesi i parë elektoral pas kësaj etape, ndaj ato janë një test i rëndësishëm i shtetit ligjor dhe për aftësinë e një sërë aktorësh institucionalë, përfshi partitë politike, për të krijuar e zbatuar standarde më të larta zgjedhore sesa në zgjedhjet e kaluara. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë parakusht për një sistem demokracie funksionale.

Organizatave të shoqërisë civile vlerësojnë në mënyrë pozitive bashkëpunimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërkohë që vlerësojnë se përpjekje të mëtejshme nevojiten për të forcuar këtë bashkëpunim si dhe rritjen e mëtejshme të nismës së KQZ-së për aplikimin e sanksioneve në rastet kur shkelet Kodi Zgjedhor. Gjatë monitorimit të proceseve të mëparshme zgjedhore janë vërejtur ndasi të dukshme mes anëtarëve të një prej organeve drejtuese të KQZ-së, përkatësisht KAS. Sugjerojmë marrjen e masave për nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet vetë anëtarëve të KAS, në kuadër të forcimit të paanshmërisë dhe paanësisë në vendimmarrjet e këtij organi.

Në dy dekadat e fundit, reforma zgjedhore vijon të mbetet monopol i partive kryesore politike, duke mos respektuar standardet e transparencës, konsultimit dhe gjithëpërfshirjes, veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile. Rasti më i fundit ishte viti 2020 kur Kuvendi miratoi në një hark të ngushtë kohor, pa studim të thelluar dhe qasje efektive konsultimi gjithëpërfshirëse, ndryshimin e neneve 64 dhe 68 të Kushtetutës që sollën ndryshimin e sistemit zgjedhor dhe ndryshime të mëtejshme në Kodin Zgjedhor, si dhe kur gjatë të njëjtit vit u bënë ndërhyrje të tjera kritike në Kodin Zgjedhor, ku parashikime të caktuara u goditën dhe pjesërisht u shfuqizuan si antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese<sup>1</sup> Vlen të theksohet gjithashtu se teksta vendi po shkon në zgjedhjet vendore 2023, Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore nuk mundësoi deri më sot, realizimin e një reforme zgjedhore, qoftë edhe të pjesshme, përpara këtyre zgjedhjeve.

<sup>1</sup> Vendimi nr.28/21 i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e pikës 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si të papajtueshëm me Kushtetutën që parashikon mënyrën e llogaritjes së votave që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti, sipas nenit 162 të këtij Kodi. Vendimi nr.31/21 për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të fjalisë së dytë të pikës 1 të nenit 162 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, në pjesën që barazon kandidatët e propozuar nga zgjedhësit me kandidatët e propozuar nga partitë politike ose nga koalicioni partish politikë.



Në këtë kuadër, në vijim të eksperiencës dhe fokusit specifik në monitorimin e proceseve zgjedhore nga secila organizatë që i bashkohet këtij reagimi, në frymën e solidaritetit dhe respektit reciprok për veprimtarinë e organizatave tona, pjesë e shoqërisë civile dhe duke patur si synim kontributin tonë modest për të fuqizuar dhe ndërgjegjësuar qytetarët si dhe nxitur aktorët përgjegjës që të garantojnë zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse, paraqesim në vijim një sërë rekomandimesh drejtuar institucioneve kompetente dhe partive politike:

→ **Rekomandime drejtuar Kuvendit të RSH**

Një reformë solide, e qëndrueshme dhe efektive kërkon ndryshime cilësore jo vetëm në Kodin Zgjedhor por edhe në ligjin mbi partitë politike. I gjithë kuadri rregullator për krijimin, identifikimin, funksionimin dhe transparencën e partive politike, demokracinë e brendshme dhe raportin e tyre me publikun, privilegjet dhe detyrimet, etj, do të duhet të jenë pjesë e kësaj reforme nga komisioni përkatës të ngritur në parlament.

Në këtë kuadër rekomandojmë që Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore të procedojë me marrjen e masave për shqyrtimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për të adresuar rekomandimet e patrajuara të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias, për një sërë paqartësish dhe mospërputhjes.

Referuar standarteve të Komisionit të Venecias (Opinion nr.190/2002)<sup>2</sup>, *“Elementet themelore të legjislacionit zgjedhor, në veçanti të sistemit të duhur zgjedhor, anëtarësimit në komisionet zgjedhore dhe përcaktimit të kufijve elektoralë nuk duhet të jenë të hapur për ndryshime në më pak se një vit para zgjedhjeve”*.

*Megjithatë, në kushtet kur na ndajnë më pak se 4 muaj para zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore, ndryshime ligjore mund të jenë të nevojshme për të depolitizuar plotësisht organet e administrimit zgjedhor (KZAZ, KQV, GNV), për të forcuar kontrollin dhe transparencën e financimit të partive politike, për të parashikuar afate realiste për verifikimin e ndalimeve të legjislacionit të dekriminalizimit të aplikueshme ndaj kandidatëve, për të zgjeruar rregulloret dhe kufijtë e shpenzimeve edhe për palët e treta (pra jo vetëm për partitë politike), etj.*

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor duhet të paraprihen nga një proces i hapur, gjithëpërfshirës dhe i drejtë konsultimi.

Përpos rëndësisë që paraqet garantimi dhe zbatimi i të drejtës për të votuar të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit, sugjerojmë rishikimin e Kodit Zgjedhor, me qëllim që të parashikojë në mënyrë të plotë dhe të qartë mundësinë dhe format e realizimit në praktikë të kësaj të drejte. Ky detyrim vjen edhe në kuadër të vendimit më të fundit të Gjykatës Kushtetuese (dt.9 Dhjetor 2022), e cila konstatoi cenimin e së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve, në zgjedhjet e kaluara për Kuvendin, për shkak të boshllëkut ligjor dhe detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Referuar garantimit të aksesit të barabartë në zgjedhje rekomandojmë ndërmarrjen e masave të veçanta dhe përmirësimin e legjislacionit për të siguruar mekanizma ligjorë (p.sh.

<sup>2</sup> “Udhezimet për Zgjedhjet” (CDL-AD (2002) 13)



përqindje e kuotës gjinore për fondet publike ose shpërndarje specifike e fondeve publike të destinuara për aktivitete të barazisë gjinore) për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në proceset zgjedhore dhe për të sanksionuar mosrespektimin e këtyre dispozitave.

Nisur nga ngjarja e paprecedentë e mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave të qytetarëve për qëllime elektorale, me anë të sistemit patronazhist, sugjerojmë që në Kreun X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve” të Kodit Penal, të shtohet një dispozite e re, duke konsideruar si vepra penale përdorimin e bazës shtetërore të të dhënave me të dhënat përkatëse për qëllime zgjedhore nga subjektet zgjedhore dhe parashikimin e sanksioneve penale përkatëse për të.

### → **Rekomandime drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Për të garantuar siguri ligjore, administrim efektiv të zgjedhjeve, si dhe për të shmangur revokimet dhe ndryshimet e shpeshta të vendimeve të KQZ-së nga vetë organet e saj drejtuese, rekomandohet të krijohet një mekanizëm më bashkëpunues ndërmjet këtyre organeve. Vlerësojmë se masa duhen marrë për rishqyrtimin e sistemit të komunikimit dhe procesin e diskutimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

Është e këshillueshme që KQZ të miratojë një udhëzues/komentar mbi shpjegimin e parashikimeve të Kodit Zgjedhor dhe administrimit zgjedhor, mbi leximin ligjor të dispozitave, afateve dhe elementëve teknikë që burojnë nga Kodi, mbi formën e votimit, fletën e votimit dhe detaje të tjera, të cilat u konstatuan problematike dhe burim konflikti institucional e politik edhe në këto zgjedhje.

Rekomandohet përmirësimi dhe forcimi i kuadrit ligjor për proceset zgjedhore dhe financimin e partive politike për të garantuar transparencë dhe kontroll më efektiv mbi financimin e paligjshëm, keqpërdorimin e burimeve shtetërore dhe presionin institucional.

Shpërdorimi i burimeve administrative shtetërore në mbledhjet apo takimet e realizuara nga përfaqësues të ndryshëm të subjekteve zgjedhore, është një nga problemet sistemike dhe nevralgjike të zgjedhjeve në vendin tonë. Ka pasur raste që qytetarët kanë luajtur rol proaktiv në denoncimin mediatik, si dhe në rrjetet e tyre sociale, të rasteve të subjekteve zgjedhorë dhe kandidatëve të tyre, të cilët kanë shkelur parashikimet e legjislacionit zgjedhor në fuqi. KQZ duhet të konkludojë me një vendimmarrje standarde, mbi marrjen automatikisht në shqyrtim dhe trajtim të denoncimit përkatës, pa qenë i nevojshëm adresimi i kërkesës/denoncimit nga një subjekt zgjedhor. Hetimi nga ana e KQZ-së duhet të realizohet brenda afateve të arsyeshme, përpara datës së zgjedhjeve, me synim kontributin në rritjen e besimit të qytetarëve tek roli i KQZ-së.

Për të mbikqyrur kufizimet e përdorimit të burimeve shtetërore në zgjedhje është e nevojshme që KQZ të ketë burimet e mjaftueshme njerëzore dhe kapacitetet për monitorimet në terren për të zhvilluar hetimet e shpejta e të plota administrative për shkeljet e raportuara, duke evituar vonesat dhe mundësuar sa më shumë të jetë e mundur vendimmarrjen përpara ditës së zgjedhjeve. Kufizimi i apelimit në KAS të çdo vendimmarrje/sanksioni administrativ të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke i trajtuar ato si masa të apelueshme në gjykatën administrative, mund të jetë një praktikë



efiçente për të inkurajuar raportimet dhe evituar interpretime/qëndrime të ndryshme të sanksioneve të Kodit Zgjedhor brenda organeve të KQZ. KQZ duhet të hartojë dhe publikojë një format raportimi për institucionet publike, për të përmirësuar procesin dhe përmbajtjen e raportimit të aktiviteteve. Kjo duhet të shoqërohet me një fushatë informuese e ndërgjegjësuere me përfshirjen e institucioneve.

KQZ duhet të zgjerojë listën e akteve të ndaluara në fushatë elektorale, përfshirë ndalimin e publikimit të aktiviteteve elektorale nga faqet zyrtare *online* të institucioneve shtetërore. Gjithashtu duhet të monitorojë praktikën e organizimeve turistike, aktiviteteve kulturore e sportive, shpërndarjen e ndihmave dhe dhuratave, të kryera gjatë fushatës elektorale nga zyrtarë politikë ose kandidatë e subjekte elektorale.

Në këtë frymë, rekomandohet rishikimi dhe ndryshimi i Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ, për raportimin e veprimtarive të ndaluara të zyrtarëve të lartë publikë, më konkretisht:

- a) Ndryshimi i pikës 1.1 e nenit 3 të Vendimit 9/2020 të duke hequr togfjalëshin “për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar”;
- b) Përfshirjen e mediave sociale në përkufizimin “media publike” duke evituar çdo lloj mangësie dhe inkoherece në identifikimin dhe përcaktimin se çfarë përbën “veprimtari publike”;
- c) Të ketë një qartësim të përgjegjësisë administrative për zyrtarët subjekt i kufizimeve të veprimtarive të ndaluara. Propozojmë që të përcaktohet më qartë në nenin 10 ndarja e përgjegjësisë institucionale dhe asaj personale në rast të mosraportimit apo promovimit të veprimtarive të ndaluara nga zyrtarët e lartë. Gjithashtu çmojnë së nevojitet të përkufizohet më qartë se cilët janë “subjektet nën përgjegjësi administrative”, për të cilët parashikohen sanksionet në nenin 10, pika 1 të këtij vendimi.

Kur ka shkelje të dukshme të Kodit Zgjedhor, të vlerësuara në frymën e praktikave të mira zgjedhore (rasti i patronazhistëve, thirrjeve për përfshirje të strukturave të pavarura dhe të depolitizuara në fushatë, kërcënime, incidente, thirrje për konflikt, etj), KQZ duhet të ketë një sistem të shpejtë reagimi apo referimi pranë institucioneve përgjegjëse, dhe në përputhje me kompetencat e saj të vendosë kur është rasti, sanksione ndaj subjekteve zgjedhore që shkelin Kodin Zgjedhor.

KQZ duhet të përfshijë në hetim të thelluar për standardet e dekriminalizimit të gjithë kandidatët e zgjedhjeve lokale, përfshirë edhe ata ndaj të cilëve ka denoncime nga shoqëria civile, media, aktorë elektorale dhe publikë, etj. Procesi i verifikimit të dokumentacionit dhe i ndërmarrjes së hetimit të thelluar duhet bërë në afatin sa më të shkurtër pas shpalljes së listave, jo pas procesit zgjedhor. Për zyrtarët në listën e sanksioneve amerikane, KQZ mund të shpallë hetime për verifikime të thelluara nga prokuroria dhe organet tona të drejtësisë.

KQZ duhet të publikojë gjetjet e monitorimit të rekordeve të komisionerëve dhe të anëtarëve të grupeve të numërimit të propozuar nga partitë politike në mënyrë që të krijohet bindja se ata nuk janë objekt ndalimi nga dekriminalizimi, nuk janë në konflikt interesi me punësimin e tyre, nuk janë të hetuar ose dënuar për vepra penale zgjedhore, etj.



I rekomandohet KQZ-së të nxjerrë një akt nënligjor për të standardizuar dokumentacionin e partive politike që duhet dorëzuar në KQZ, (vendim i gjykatës, lista e kryesisë, lista e kryetareve lokale, vendimmarrja e organit që ka propozuar kandidatet, vendime të verifikimit të hershëm të kandidatëve (138/2015 dhe Autoriteti i Dosjeve). KQZ mund të theksojë me vendimmarrje detyrimin e subjekteve për të plotësuar një CV shumë më të detajuar dhe të saktë, sa i përket të dhënave personale të kandidatëve, sesa modeli aktual i përgjithshëm. KQZ duhet të zgjerojë dokumentacionin e kërkuar për një subjekt elektorale për t'u regjistruar në zgjedhje, duke provuar me dokumentacionin e përshtatshëm se kanë adresë të saktë, të verifikueshme, kontratë zyre dhe anëtarë.

***Mbështesim në mënyrë të veçantë rekomandimin e OSBE/ODIHR në raportin e fundit të monitorimit të zgjedhjeve në Shqipëri, që në mënyrë që të rritet përgjegjësia e partive politike dhe transparenca e përgjithshme e procesit zgjedhor, duhet të merret në konsideratë që t'u kërkohej garuesve të zbulojnë të ardhurat dhe shpenzimet e tyre të fushatës para ditës së zgjedhjeve.***

Deklarimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të realizueshme jashtë llogarisë zyrtare të subjektit zgjedhor, nga fondacionet politike, media partiake, organizatat partnere, etj, të krijuara nga vetë subjekti zgjedhor, nuk duhet të mbetet jashtë mbikqyrjes e kontrollit nga KQZ.

Për të garantuar aksesin e barabartë dhe vlerësimin përkatës, rekomandohet përmbledhja i të dhënave të ndara sipas gjinisë për shpërndarjen e financave dhe raporteve financiare nga partitë politike.

KQZ duhet të monitorojë edhe emisionet speciale televizive dhe mediatike të financuara dhe të dedikuara për kandidatët dhe partitë, jashtë edicionit të lajmeve, duke i trajtuar ato si kohë televizive dhe reklamë për kandidatët. Rekomandohet krijimi i udhëzimeve për partitë politike për të garantuar akses të barabartë të kandidatëve burra dhe gra në kohën e transmetimit falas në media gjatë fushatave zgjedhore, sipas nenit 80 të Ligjit Zgjedhor.

Trendi i votave të pavlefshme të konstatuara në proceset zgjedhore ka qenë i luhatshëm. Duhet forcuar kapacitetet e KQZ-së për të shtrirë urat e komunikimit, duke orientuar dhe ndërgjegjësuar zgjedhësit për mënyrën e votimit, duke parashikuar një shtrirje edhe drejt zonave rurale të vendit, zgjedhësit e të cilave kanë aksesueshmëri të kufizuar në mjete teknologjike dhe audio-vizuale.

Thelbësor mbetet informimi në kohë dhe i qartë i zyrtarëve subjekt i kufizimeve të ndalimeve që parashikon Kodi Zgjedhor, si dhe i publikut. Ky proces mbetet i nevojshëm për të siguruar ndërgjegjësimin si dhe besimin e duhur të subjekteve zgjedhore dhe qytetarëve për të bashkëpunuar në denoncimin e rasteve të abuzimit.

I rekomandohet KQZ-së të monitorojë proaktivisht cilësinë e trajnimeve të realizuara me komisionerët e organeve të administrimit zgjedhor (KZAZ, KQZ, GNV), përfshirjen dhe interesin e shprehur nga ana e përfaqësuesve të emëruar të administratës zgjedhore për të qenë komisioner, si dhe mirë planifikimin e këtyre trajnimeve në kohë.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga përdorimi i telefonave celularë nga zgjedhësit, sugjerojmë interpretimin e zgjeruar nga ana e organeve përgjegjëse të administratës zgjedhore dhe atyre



hetimore, për interpretimin e zgjeruar të nenit 109 pika 2 të Kodit Zgjedhor për ndalimin e mbajtjes së telefonit ose çdo pajisjeje regjistrimi, në ambientet e dhomës së fshehtë të votimit.

### → **Rekomandime drejtuar Organeve të Sistemit të Drejtësisë**

Indicie dhe akuza për shitëblerje të votave gjatë procesit parazgjedhor në zgjedhjet e fundit, përfshi ato parlamentare, janë sinjalizuar në disa prej bashkive të vendit. Hetimi i prokurorisë duhet të jetë më i shpejtë, objektiv, i gjithëanshëm dhe i plotë.

Është e papranueshme për publikun që fenomeni i përsëritur i shitblerjes së votave të hetohet me një qasje të ngushtë, duke ngarkuar me përgjegjësi individë të caktuar të cilët veprojnë me statusin e ndërmjetësit për blerjen e votave. Skema të tilla duhet të hetohen me teknika të posaçme hetimore, në mënyrë pro-aktive dhe që të mundësojnë ndëshkueshmërinë e çdo përfaqësuesi të subjektit zgjedhor, pa asnjë dallim, pavarësisht rolit dhe pozicionit që ka pranë strukturave të subjektit zgjedhor. Vetëm në këtë mënyrë, mund të ecet drejt rrugës së ndëshkueshmërisë së krimit zgjedhor, parandalimit efektiv të skemave të shitblerjes së votave dhe rrjedhimisht të garantohet integriteti i votës së çdo qytetari.

I sugjerojmë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme veç njoftimeve periodike që kanë të bëjnë me denoncimet e veprave penale në fushën e zgjedhjeve të angazhohen në publikimin në kohë, të treguesve kryesorë që kanë rezultuar nga hetim i çështjeve të tilla. Për të kapërcyer problemin e bashkërendimit të statistikave të paplota ose kontradiktore të ofruara nga institucionet e sistemit të drejtësisë penale, duhet të zhvillohet një sistem i përbashkët regjistrimi efektiv, që përfshin të gjithë hapat e procedimeve.

SPAK duhet të ketë burimet e mjaftueshme njerëzore për të kryer në kohë dhe në mënyrë efektive hetimin e veprave penale të parashikuara nga nenet 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe 328/b “Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, të Kodit Penal .

Sugjerojmë rritjen e sanksioneve penale ndaj shkeljeve, si abuzimi apo shpërdorimi i burimeve administrative shtetërore, kur kjo përbën vepër penale sipas nenit 328/a të Kodit Penal, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”.

Për të rritur besimin e publikut tek procesi zgjedhor në tërësi, dhe efektiviteti i ndëshkueshmërisë, duhet rritur transparenca nga ana e organeve të zbatimit të ligjit dhe atyre proceduese, për vijueshmërinë e hetimit dhe gjykimin të këtyre veprave penale.

### → **Rekomandime drejtuar KDIMDHP**

Nisur nga një databazë e paprecedentë që qarkulloi për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale për 910 mijë shtetas/zgjedhës në zgjedhjet e kaluara parlamentare, është e rëndësishme të sjellim në vëmendje të subjekteve zgjedhore se nuk mund të mbajnë të dhëna personale dhe sensitive të zgjedhësve, pa miratimin dhe autorizimin e tyre.

I rekomandojmë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të ushtrojë gjatë kësaj periudhe, në mënyrë sistematike, rolin e tij mbikqyrës, me profesionalizëm dhe objektivitet ndaj subjekteve zgjedhore që mbledhin dhe përpunojnë të



dhëna, bazuar në ligjin nr.9887 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar), dhe aplikimin e sanksioneve ndaj subjekteve që gjenden në shkelje të ligjit.

→ **Rekomandime ndaj kryetarëve të Njësive të Qeverisjes Vendore**

Edhe praktika e zgjedhjeve të mëparshme si dhe monitorimi i zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit 2021 ka vërtetuar se njësitë e qeverisjes vendore në disa QV nuk marrin masat paraprake që ditën e votimit t’u krijohen lehtësitë e nevojshme personave me aftësi të kufizuara që e kanë vështirë lëvizjen pa ndihmesën e mjeteve përkatëse. I sugjerojmë kryetarëve të këtyre njësive të marrin informacionin përkatës për zgjedhës të kësaj kategorie, si dhe të bashkë-koordinohen në kohë reale me KQZ-në për gjetjen e zgjedhjeve alternative për të garantuar të drejtën e votimit pa asnjë diskriminim, e në mënyrë gjithëpërfshirëse ndaj të gjithë zgjedhësve.

Procesi i njoftimit të zgjedhësve në banesa të jetë sistematik deri në publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve; Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore të njoftojnë në mënyrë provuese çdo 15 ditë KQZ-në, mbi realizimin e kësaj detyre.

→ **Rekomandime drejtuar Partive Politike**

Bazuar në nevojën për garantimin e integritetit të kandidatëve, në kushtet e zbatimit të legjislacionit të posaçëm për dekriminalizimin, i rekomandojmë subjekteve përkatëse zgjedhore, me pëlqimin e mundshëm të kandidatëve pjesë e listave, jashtë periudhës zgjedhore ose menjëherë pas regjistrimit të tyre në KQZ, të kërkojnë verifikimin e thelluar pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim që kjo e fundit të ketë kohën e nevojshme në dispozicion për të kryer këto verifikime.

Duke marrë shkas nga vështirësitë me të cilat është ndeshur Prokuroria e Përgjithshme në verifikimin e të dhënave për kandidatët, nëpërmjet përdorimit të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, me synim respektimin e afateve ligjore, i sugjerojmë vetë subjekteve zgjedhore marrjen e masave për verifikimin paraprak të kandidatëve, për të garantuar realizimin e një gare meritokratike dhe të ndershme.

Partitë Politike duhet të promovojnë kandidatë për kryetarë Bashkie, të zgjedhur brenda partisë me anë të një gare të ndershme dhe procedure meritokratike, të cilët paraqesin programe politike të plota, realiste, transparente dhe përfaqësuese të interesave të qytetarëve për të krijuar besim dhe pritshmëri në përmbushjen e premtimeve elektorale.

Garantimi i aksesit të barabartë në burimet financiare nëpërmjet:

- Krijimit të mekanizmave për të garantuar një akses të barabartë të kandidatëve (burra dhe gra, pavarësisht nga pozicioni i tyre në listën e kandidatëve) në fondet publike gjatë fushatës zgjedhore.
- Krijimi të politikave të brendshme që garantojnë barazi gjinore dhe akses të barabartë në burime, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore.

**Me synim përfaqësimin e interesave politikë të zgjedhësve nga kandidatë banues në zonën përkatëse zgjedhore, i sugjerojmë subjekteve zgjedhore përfshirjen në lista të kandidatëve për kryetar bashkie, pjesë e Bashkisë, përpara kandidimit. I njëjti**



**rekomandim vlen edhe për kandidatët për këshilltarë bashkiakë, të cilët duhet të reflektojnë në databazën online të KQZ-së, zonën aktuale të banimit.**

Për pasjen e një demokracie funksionale dhe llogaridhënëse gjithëpërfshirja e grupmoshave të ndryshme në proceset elektorale mbetet synim sfidues. Partitë politike duhet të krijojnë një mjedis më të hapur dhe konkurues për të rinjtë, simpatizantë të subjekteve zgjedhore, në mënyrë që të rrisin besimin e zgjedhësve të rinj, si dhe të harmonizojnë programet politike me pritshmëritë e vizionet e të rinjve.

Një aspekt me rëndësi të vecantë është dhe garantimi i llogaridhënies dhe transparencës dhe zbatimi i rregulloreve dhe mekanizmave të informimit dhe monitorimit që sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin e financave politike, si dhe sigurimi dhe shpërndarja e informacionit gjithëpërfshirës për kandidatët dhe publikun mbi përdorimin dhe shpërndarjen e financave publike gjatë fushatave elektorale.

**Organizatrat partnere nënshkruese (renditur sipas rendit alfabetik):**

1. **Akademia e Studimeve Politike (ASP)**
2. **Instituti i Studimeve Politike (ISP)**
3. **Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)**
4. **Qëndresa Qytetare**
5. **Rrjeti i Grave “Barazi në Vendimmarrje”**